

08 gusht 2006

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË BORDIT

Të pranishëm:

Nick Frydas **N.F.** *Kryesues i Bordit*.....

Theranda Beqiri **Th.B.** *Anëtare e Bordit*

Naim Bejtullahu **N.B.** *Anëtar i Bordit*

Nysret Avdiu **N.A.** *Anëtar i Bordit*

Azem Kastrati **A.K.** *Shef i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve*

.....

Është propozuar prej **NF** që pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës të shtyhen për mbledhjen tjetër, prandaj takimi filloi me pikën 4 e cila ishte ankesa prej Mullirin BIRILIK.

1. Ankesa e Mill BIRILIK në DMK ZRRE– A.K. shpjegoi situatën e Mulliri BIRILIK dhe se DMK-ja nuk ka marrë përllogaritjen e duhur të energjisë së peregjistruar e cila i është kërkuar KEK-ut. Më 08.08.2006 rreth orës 10 DMK-ja ka marrë disa përllogaritje të cilat nuk kanë qenë në përputhje me atë që i ka propozuar kjo e fundit KEK-ut.

Ankesa kishte të bënte me ngarkesën e një shume nga KEK-u ndaj konsumatorit, që kishte të bënte me konsumimin e energjisë së paautorizuar, pra me regjistrimin e pasaktë të energjisë së shfrytëzuar nga ana e njehsorit të energjisë elektrike. KEK nuk ka arritur të provojë nëse njehsori i energjisë elektrike ka qenë i prishur(i korruptuar). **AK** shpjegoi se sipas regjistrave të KEK-ut, vizita e parë është bërë më 20.05.2004; në vizitën e tretë, ekipi i KEK-ut ka gjetur se fazat ishin ndryshuar dhe kjo ka qenë arsyeja pse energjia e konsumuar nuk ka qenë e regjistruar. Në vizitën e dytë, ata gjetën daljet e pablombuara (pa vulë) në njehsor dhe më 11.06. 2004, KEK blomboi daljet e njehsorit, dhe ka bërë leximin e njehsorit deri më 11.09. 2006, ndërsa kanë vërejtur se është konsumuar më shumë energji sesa ka qenë e njehsuar. Për këtë arsye, përllogaritja është bërë si vijon: mesatarja e konsumimit për tre muaj dhe kjo është shtuar për 12 muaj prej 11.09.2006, që bën shumën prej 18,446.72 Euro.

Meqenëse KEK-u nuk mund të provojë se njehsori ka qenë i korruptuar, ata supozojnë se për shkak të ndryshimit të fazave dhe mosblombimit të dy daljeve të njehsorit, ka qenë duke regjistruar vetëm 1/3 e energjisë së konsumuar. Vendi është vizituar nga ekipi i DMK-së së ZRRE-së. **NA** shpjegoi se Mill është i kyçur në rrjetin elektrik qe prej viteve (70’), dhe stacioni i transformatorëve është në pronësi të tijën dhe po mbahet e mbyllur. Askush nuk mund të hyjë pa aprovimin e tij, përveç ekipeve të KEK-ut.

Si përfundim, **AK** përmendi se procesi i kryer nga ekipet e KEK-ut është i një niveli të ulët.

NF deklaroi se ZRRE-ja nuk ka këtë lloj rregulloreje mbi përllogaritjen. **NB** deklaroi se Rregulli mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji kërkon që KEK-u të zhvillojë një metodologji e cila duhet të miratohet nga ZRRE-ja, duke përfshirë metodologjinë për

përllogaritjen e energjisë së paautorizuar. **AK** deklaroi se kjo është një ankesë e vitit 2004 dhe ZRRE-ja ka autoritetin për ankesat e asaj periudhe.

NB tha se ZRRE-ja mund të marrë një vendim për të lejuar KEK që të përllogarisë energjinë e panjehsuar. **AK** përmendi se në bashkëpunim me ZRRE-në, Departamenti Ligjor, nuk ka baza ligjore për këtë përllogaritje. **NA** theksoi se Departamenti Ligjor i KEK-ut nuk po funksionon aspak dhe si rezultat i kësaj, mungojnë detajet për të zgjidhur këtë rast. **NF** theksoi se kjo mund të jetë një paralajmërim për KEK-un që të kryejë si duhet punën.

AK propozoi që në përputhje me Nenin 18.5 të Rregullit mbi Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, ZRRE-ja të mos marrë një vendim dhe t'i sigurojë palëve një shpjegim me shkrim në lidhje me arsyen e vonës dhe datën e menduar të vendimit. Gjithashtu t'i dërgohet KEK-ut një paralajmërim në rast se i gjithë procesi është i përgatitur si duhet, bordi i ZRRE-së do të votojë negativisht.

Është vendosur se në mbledhjen e 08.08.06, Bordi i ZRRE-së ka ekzaminuar Ankesën e konsumatorit Mulliri Birilik dhe bazuar në Nenin 18.5 ka vendosur të shtyjë vendimin duke pritur dorëzimin e dokumenteve nga KEK-u për të justifikuar sasinë e pa-njehsuar të energjisë, sipas Ligjit dhe rregulloreve të aplikueshme. Në rast se DMK-ja nuk merr informacionin e kërkuar, ZRRE-ja do të vendosë në favor të konsumatorit. Kjo do t'i kopjohet edhe konsumatorit dhe KEK-ut.

2. **Përkthyesi i Gjuhës Shqipe – AB** përmendi se kanë aplikuar 6 kandidatë. Që të gjithë janë ftuar por vetëm katër prej tyre kanë marrë pjesë në intervistë. Sipas panelit, Znj. Alketa Sala është zgjedhja e parë, Z. Jeton Ademi i dyti dhe Z. Nimon Jusaj i treti. Që të tre janë shumë të mirë në anglisht, (në të folur dhe të shkruar). Z. Nimon Jusaj ka përkthyer Ligjin mbi Energjinë dhe Energjinë Elektrike. **TB** tha se do të presin deri të premtën për përgjigjen e Znj. Sala, dhe nëse ajo deri atëherë nuk ka marrë një vendim, atëherë do të kalojë në zgjedhjen e dytë. **NA** propozoi që zgjedhja e dytë të jetë Nimon Jusaj meqenëse ka përkthyer Ligjin mbi Energjinë dhe atë mbi Energjinë elektrike. Nëse Znj. Sala tërhiqet të premtën, atëherë do t'i jepet një mundësi të dytit (Z. Nimon Jusaj), dhe më pas i treti do të jetë Z. Jeton Ademi.

NF tha se me pëlqimin e shumicës së anëtarëve të bordit, Z. Alketa Sala është kandidatja e përzgjedhur për pozitën e Përkthyesit Shqip me Z. Jeton Ademi si zgjedhje e dytë dhe Z. Nimon Jusaj si e tretë. Dy kandidatët e tjerë do të informohen nga **AB** që të presin deri të premtën për vendimin përfundimtar.

3. **Konsultim publik mbi Shqyrtimet e Çmimeve– TB** përmendi se datat janë vendosur në Planin e Zbatimit dhe në Njoftimin e Shqyrtimit të Çmimeve. Do të jetë në fillim të shtatorit. **NF** tha se duhet të zgjidhet një datë për arsye se ZRRE-ja duhet të informojë publikun. **NA** propozoi të martën më 12 shtator 2006. **TB** ra dakord me të si datë duke shtuar se të gjithë konsulentët do të jenë këtu në fillim të shtatorit, dhe mund të merren masat. **NF** përmendi se do të merret një vendim i ZRRE-së mbi kostot e Lejuara dhe se sipas legjislacionit të ZRRE-së për këtë ka edhe një afat përfundimtar. Nëse ne shkojmë pas, edhe vendimi duhet të kthehet pas dhe do të marrim edhe një vendim mbi normën e lejuar të kthimit.

TB theksoi se meqë vendimi për MPKK është shtyrë për një javë, ne jemi duke sugjeruar 12 shtatorin 2006 si një datë të përshtatshme për Dëgjimin Publik në Të ardhurat vjetore të Lejuara të KEK-ut dhe KOSTT dhe për Strukturën Tarifore. KEMA ka premtuar se do të kthehen me shifrat për Dëgjimin Publik.

4. **MM me MEF – NF** përmendi se Shqyrtimi i Buxhetit të ZRRE-së prej shtatorit-dhjetor 2006 është dërguar në Kuvendin e Kosovës dhe ka kërkuar një shpjegim nëse ZRRE-ja duhet ta

dërgojë atë çdo vit. **PJ** tha se MEF punon me Vit Fiskal dhe ZRRE-ja duhet të paraqesë për vitin e plotë 2007 diku nga fundi i tetorit ose fillimi i nëntorit. Në këtë kohë, ZRRE-ja do të pajiset me informacionet nëse BE-ja do të vazhdojë të financojë punonjësit lokalë të ZRRE-së.

NF pyeti nëse ZRRE-ja duhet të nënshkruajë MM me MEF-in. **PJ** u përgjigj se sipas Z. Agim Krasniqi, Sekretar Permanent në MEF, nuk ka nevojë. Ai ka thënë se Ministri i MEF-it nuk ka të bëjë asgjë me këtë dhe se ZRRE-ja duhet të vazhdojë të ndjekë Ligjin dhe Propozimi i Buxhetit duhet t'i dërgohet Kuvendit të Kosovës. Ata ose do ta aprovojnë, ose do të kërkojnë më shumë detaje. **PJ** theksoi se Z. Krasniqi ka thënë se ZRRE-ja si organizatë nuk mund të vendosë për pagat e veta dhe se kjo duhet të miratohet nga Kuvendi. **NF** pyeti se kush do të veprojë me llogarinë e hapur në BKP. Aty nuk janë vendosur emrat e personave të autorizuar. **NA** tha se sipas Ligjit, vetëm parlamenti e shqyrton buxhetin e ZRRE-së dhe nuk e aprovon atë. **PJ** sugjeroi që pasi kuvendi t'i jetë përgjigjur, ZRRE-ja të përgatitet për detyrat e shtuara dhe veçanërisht të Departamentit të Administratës dhe Financave. **NF** përmendi se edhe konsulentët (NERA) duhet që të angazhohen në këtë. **PJ** përmendi urgjencën e punësimit të një llogaritari të certifikuar dhe një auditori të brendshëm.

NF sugjeroi që **PJ** të kontaktojë Patrick Vander Laan në BE në lidhje me Rregullat Financiare dhe **AB** të kontaktojë zyrën e Auditorit të Përgjithshëm brenda MEF. **NA** do të pyesë në lidhje me llogarinë e hapur bankare brenda BKP-së.

5. Alokimi i Kapacitetit Ndër-Kufitar

NF përmendi se KEK ka marrë një faks prej EMS në lidhje me ndryshimin e kapaciteteve të alokuar në Kufinj të tyre. Në shkurt 2006 ka pasur një tender transparent për importin; ZRRE-ja ka qenë e pranishme në monitorimin e këtij tenderi dhe tre tregtarëve: EFT nga Serbia, ESP nga Republika Çeke dhe EGL nga Zvicra dhe secili ka pasur sasi të ndryshme. ZRRE-ja është kontaktuar dy herë nga EGL duke u ankuar se EMS nuk e ka lejuar EGL që të ketë kapacitete në kufinj. ZRRE-ja ka pasur si detyrë që të mos favorizojë asnjë por që të mundësojë për të gjithë tregtarët që të ofrojnë produktin e tyre pasi vetëm konkurrenca mund t'i ulë çmimet. Për këtë arsye, **NF** propozoi që të dërgojë një letër në EMS ku të thuhet se kapaciteti që kërkohet nga KEK për t'u importuar çdo muaj, duhet të klasifikohet si një kapacitet tashmë i alokuar, në mënyrë që të plotësohen detyrimet publike, dhe për më tepër nuk ka pasur tender transparent dhe çdo tregtar është caktuar për sasi të specifike.

NB sugjeroi që të mos i shkruajë direkt EMS, se ZRRE-ja nuk ka autoritet mbi EMS. Ose ZRRE-ja do t'i shkruajë Rregullatorit të Serbisë. Nëse ZRRE-ja vendos t'i shkruajë OST-së serbe, ajo duhet të shfrytëzojë pozitën e vet aktuale në SETSO Task Force. Letra duhet t'i kopjohet EMS, Ministrisë së Energjisë dhe Minierave në Serbi dhe palëve të interesuara në Kosovë, Shtyllës së IV të UNMIK-ut.

NF përmendi se ZRRE-ja nuk mund t'i imponojë asgjë OST-së serbe por mund t'i imponojë KEK-ut që të mos bëjë diskriminim. KEK-u po importon nga NEK, por NEK ka refuzuar në vazhdimësi që të marrë një licencë në Kosovë. **NF** sugjeroi se KEK-ut duhet t'i thuhet që ata nuk duhet të bëjnë ujdë me tregtarë që refuzojnë të aplikojnë për licencë.

Në lidhje me këtë, Bordi i ZRRE-së, ka vendosur t'i përgjigjet Rregullatorit të Serbisë dhe t'i kërkojë që të vazhdojnë regjimin ekzistues dhe të marrin një vendim si masë parandaluese për të lejuar vetëm importet e energjisë sipas tenderit të caktuar më 6 shkurt 2006.